

LEGJENDA U BË NJËMENDËSI

● Fenomen e fjalë e re — gjinidërrimi ● — A ka shumë njerëz që do të dëshironin ta ndërrojnë gjininë ● — Kush ia nisi më së pari

S'ka rëndësi nëse njerëzit e parë u quajtën Adam e Evë, apo Adem e Havë. Secila fe, religjion, i ka shpjegimet e veta, edhe emrat e tyre. Por, kjo është punë dogme. Shkenca gjerat i spjeron ndryshe. E njerëzit u besonin dogmave,

pikërisht nga kjo arsye «gjetën» legjendën për ylberin, duke u detyruar kështu të pajtohen me fatin ose të vazhdojnë të jetojnë me dëshirën e tyre të ndryrë e të pasendërtueshme, me gjininë që kishin lindur.

het, lëkura e fytyrës iu bë më delikate, i tretën shenjat e mashkullit të dikurshëm.

Por, rasti s'mbeti i vetmuar. Me këtë fenomen filluan të merren specialistë të kirurgjisë e të gjinekologjisë, psikiatër... Tash ka lindur edhe një emër i



Një pamje e Lublanës

sepse nuk dinin t'i spjeronin ndryshe fenomenet e natyrës. Bile njeriu shpiki legjenda edhe për dëshirat e veta të papërbushura, i mistifikoi ato në shkallën që i bënte ato të pasendërtueshme.

«Kush do të mundte ta kapërcente ylberin, do ta ndërrointe gjininë» — thoshte legjenda, të cilën askush deri më sot nuk ia doli ta provonte. Se ylberi ikte, edhe mbas shtatë bjeshkësh, dhe njeriu jo vetëm që s'mund ta kalonte, por as t'i qasej.

Shekujt, megjithatë e ruajtën legjendën, që të arrinte deri në ditët tona, kur shumë-çka po demistifikohet. Në Hënë është vërtetuar se nuk ka kuçedra; se dielli kur zihet, nuk kthjellat nga frika e daulleve; se toka nuk dridhet nga kau i zi; se... një mijë e njëqind gjera të paspjegueshme, tashmë nuk janë të tilla.

Njeriu, por, ka mbetur qenia më e komplikuar. Dhe derisa ai po arrin në Hënë e më tej, derisa po i spjeron fenomenet e pakapshme për mendjen e tij deri dje, i mbetet të zbulojë edhe shumë misterie, dhe — pikërisht për vetveten.

Sidoqoftë njeriu lindet e rritet bashkë me ndonjë dëshirë të veçantë, se natyra nuk ia ndoqi qejfin, nuk ia dha gjithë çfarë deshti.

Ka, ta zëmë të tillë që nuk janë të kënaqur me gjininë që kanë. Ato do të dëshironin të ishin ata, ose ata — ato. Dhe

Ata (ato) dëshirojnë të bëhen ato (ata)

Edhe sot ka njerëz që do të dëshironin të ishin diç tjetër nga ç'i ka falur natyra, më shkurt: ta ndërrojnë gjininë. Të tillët intimisht nuk e ndiejnë veten në rolin që kanë si përkatësi e një gjinie, do të dëshironin të ishin ashtu si dëshirojnë, si i përjetojnë intimitet.

Fenomeni s'është i rrallë as i ri. Se nuk është i ri e dëshmon edhe legjenda e ylberit. E se nuk është i rrallë ka të dhëna statistikore (sigurisht jo të sakta) dhe prova ekspertësh. Edhe shtrirja e tij nuk mund të lokalizohet, meqë këso dëshirash për ta ndërruar gjininë ndeshen në çdo vend e në çdo komb.

Ata që merren me këtë çështje pohojnë se sot një deri dy nga 100 mijë meshkuj do të dëshironin të ishin femra, të kenë gjokse të fryra e vithe të gjera, të kënaqen me përqaftimet e meshkujve, të gjinisë që i përkasin edhe vetë. Në anën tjetër, një deri dy femra në 400 mijë sosh, do të dëshironin të luanin rolin e mashkullit kundruall gjinisë së vet.

Nëse dikur dëshirat e tilla intime ishin sekrete, të cilat varroseshin bashkë me njeriun, sot ato nuk janë më fshehtësi për opinionin, e aq më pak për specialistët — mjekë. Në klinika të qendrave të ndryshme të botës sot të tillët kërkojnë jo vetëm këshillë mjekësore, por edhe intervenime kirurgjike. Bile tash s'është habi nëse dikush shfaq dëshirë të tillë.

Mjekësia bashkëkohore ia ka dalë që ëndrrat e tilla t'i kthejë në njëmendësi, në realitet. Sot s'janë pak ata që dikur ishin meshkuj e që janë bërë femra, as ish-ato që janë bërë meshkuj, ata.

Kush e filloi...

Pas Luftës së Dytë Botërore, një ushtar amerikan kërkoi nga mjekët në Danimarkë që t'ia ndërrojnë gjininë. Dhe ai një ditë u bë ajo, jo vetëm me dëshirë, por edhe me pamje. Ish-atij iu frynë gjokset e vit-

ri për ata që merren me këtë çështje — transeksualistë. Dhe derisa zëmë të gjurmohet rreth këtij problemi në vendin tonë, vëshitërisia e parë në të cilën ndeshëm ishte termi, si t'i themi shqip. U konsultuam edhe me ekspertë dhe e pagëzuam — gjinidërrues (për ata që bëjnë ndërrimin e gjinisë) dhe gjinidërrimi — si veprim. S'dimë nëse ia qëlluam, por edhe kjo le të mbetet çështje për gjuhëtarët, meqë ky fenomen, me gjasë, nesër do të jetë më i shpeshtë. Se njerëzit nuk i fshehin më ndjenjat intime si dikur, ato i manifestojnë botërisht, pa komplekse. Gjinidërruesit së pari filluan të merren me këtë punë më dendur në qendra mjekësore të Afrikës Veriore, Kazablankë, ta zëmë, e kjo i shtyri ekspertët evropianë të kapen me çështjen më seriozisht. Të pakënaqur me gjininë u dolën në ndihmë mjekët e Mynhenit, që pastaj të zgjerohet nëpër qendra të tjera të Evropës. Nga burimet marrim vesh se ndër ata që u mësynë qendrave mjekësore evropiane me hallin e gjinidërrimit kishte edhe qytetarë jugosllavë.

E sivjet, për herë të parë në analet e mjekësisë jugosllave, një punë të tillë, ndërrimit të gjinisë, iu hy në Lublanë. Lajmi u përhap si vetëtimë dhe u shënua edhe në mjetet e informimit. U muar vesh se protagonistët për opinionin ishin anonimë, mbahehin fshehtë. E për motivet, do të marrim vesh më vonë, sikundër edhe për një kosovar që u bë kosovare, pikërisht në Lublanë.

Kush është ai (ajo), prej nga dhe si i lindi kjo dëshirë, janë çështje për të cilat bën fjalë ky fejtën në vazhdimet e ardhshme. Por, s'është fjala vetëm për një senzacion sa për një të arritur të shkencës, për mbizotërimin e mjekësisë ndaj natyrës.

Nesër:

**PIKËNISJA
NGA HIÇGJË**

PIKËNISJA NGA HIÇGJË

- Një lajm, pa protagonistin, s'mjaftonte për ta identifikuar atë që e kishte ndërruar gjininë ● Mjeku kryesor as që don të bisedojë për këtë çështje që mbahej »tepër rezervat« ● Si e mësova emrin e ri të Misinit

Gazeta »Dello«, e përditshme e Lublanës, e para njoftonte lexuesit e vet për suksesin e mjekëve të Qendrës Klinike Medicinale të kryeqytetit të Sllovenisë. Mirëpo, gazeta asgjë s'konte më shumë se ekipi i mjekëve të kësaj qendre ia kishte dalë t'ua ndërronte gjininë pesë pacientëve. Përkush do të ishin ata?

Se do të ishte ndonjë kosovar ndër ta, as që më ngacmonte kureshtja profesionale. E vetmja gjë që më shtynte të

jashtë kufijve. Formalitetet u bënë, por takimi i parë me dr. Jozhe Llokarin sikur s'jepte shpresë për një bisedë më të hollësishme rreth ndërrimit të gjinisë.

— Sa i kemi bërë hapet e parë njëmend të suksesshëm, për ndërrimin e gjinisë së atyre që duan. U muar vesh, seleksionimi është një punë e vështirë dhe me përgjegjësi. Mirëpo, për këtë gjë asnjë fjalë më shumë s'ta them. Kemi përvojë të keqe me gazetaret.

Do ta mësonim edhe emrin e ri

Asnjë hollësi tjetër s'kishim për gjinindërruesin, tash më kosovarë, njërit nga ata tre meshkuj që ishte kthyer në femra, e as për ato të dyjat, që ishin bërë ata të dy. Një gjurmë të re tash e dinim: ai që ishte bërë ajo (një prej tyre)

çonte kah Maribori. E kush do të jetë më kompetent se organet e SPB-së për identifikim. Kryeshefi i SPB-së, Albin



PEJA: KËTU KISHIN MBETUR SHPRESAT

trokasë në dyert e këtij institucioni ishte se a mund të kenë sukses intervenimet e tilla kirurgjike, a njëmend mund të ndërrohej gjinia, të mësoja për një kuriozitet medicinal, apo ishte fjala për lajme që gazetat i botojnë për ngritur tirazhet e tyre.

Kisha lexuar se në vende të tjera kishin ndodhur këso gjerash, bile edhe se ishin bërë operacione të suksesshme. Çështjen e kuptoja si një sukses, të mbërrime epokale të mjekësisë. Kështu, zatiën edhe duhet marrë e gjithë përpjekja e gazetarit për t'i vërtetuar të dhënat e atij lajmi të mëngët për nga të dhënat, hollësitë.

Hapi i parë dhe »sharra — në gozhdë«

Në Qendrën Klinike të Medicinës në Lublanë tash e vjetër më parë punon një ekip mjekësh — specialistë të ndryshëm, të rryer, i — cili shenoj sukseset e rralla nga fusha e mjekësisë. Ata ia dolën t'ia ngesin gishtin një pacienti 24 orë pasi e kishte këputur në tërësi, bile pa lënë kurrfarë pasojash. A s'ishte ky një motiv i mjaftueshëm për gazetarin që të bisedonte me ta, qoftë edhe vetëm për këtë çështje?

Në Qendrën Klinike kërkohet audiencë te udhëheqësi i këtij grupi specialistësh, që tashmë u kishte dalë zëri edhe

E dini, ky hap e ka ndarë opinionin në dysh, në ata që përkrahin një ndërmarrje të tillë, dhe në — kundërshtarë. Të dytët janë më me shumicë. Por, pengesa kryesore që të bisedojmë më hollësisht është e dhëna se pacientët nuk dëshirojnë të identifikohen ngase, sipas kërkimeve të deritashme, kjo mund të jetë fatale për ta, mund të ketë pasojë psikike

Ky ishte hapi ynë i parë dhe dëshprues.

Muarëm vesh se as organet kompetente për identifikim nuk japin shënime për opinion, sepse në dosjet e klientëve të tillë shkruan »tepër rezervat«.

Përpak të dorëzoheshim. Prof. dr. Jozhe Llokar, megjithatë, gjatë bisedës na lë një fije shpresë. Na thotë: »Gjithë ç'është për opinionin, i gjeni në gazetën reviale »Telex«.

Por, puna e këmbëngultë gjithmonë paguhet. Nëse dështoi përpjekja që përmes sekretarësh së mjekut të mësonim ndonjë hollësi për këtë rast, takimi me gazetarin që e kishte dhënë lajmin në »Dello«, Jozhe Vetrovcin, ngacmonte kureshtjen që mos të ndaleshim.

Ndër të tjera më thotë: »Kjo është një ngjarje e madhe për zhvillimin e mjekësisë ndër ne. E dini, ndoshta, se ndër pesë pacientët është edhe një kosovar«.

Privshëk, është kategorik: asnjë element identifikim s'e japim. Derisa ai po i rikontrolonte të dhënat, tash duke përmbytur kureshtjen e vet, lexojmë mbi një dosie emrin Alexandra (Aleksandra) dhe mbiemrin — Krasniqi. E dija se kjo që bëra ishte punë e palejueshme, bile edhe e pander-shme.

E lusim të na thotë, së paku, prej nga është. Por, pra-pë asgjë.

Edhe një lutje, që ndoshta do ta ngushtonte rrethin për ta identifikuar vashën që pak muaj më parë kishte qenë djalë. Miqësisht kërkujmë të na thotë ai ishte ai (ajo) nga fshati apo ndonjë qytet i Kosovës. Ky fakt, ndonëse në dukje i parëndësi, na dukej se do të hapte mundësi të reja për ta identifikuar. Marrim përgjigje: »Nga qyteti është«.

Mbetej të ktheheshim në Kosovë dhe të hulumtonim nga një qytet në tjetrin. Në Prishtinë, Mitrovicë e Prizren, përpjekjet dështuan. Mbetej Peja, ku ka më shumë mbiemra Krasniqi. Ky fakt, ç'është e vërteta, m'u kujtua pak me vonesë.

Por, kujt t'i drejtoheshim që t'i kapnim fijet e ngjarjes së më shkurt?

Nesër: MOS ËSHTË GABIM I OFIÇARIT?

MOS ËSHTË GABIM I OFIÇARIT?

● Si ia mësova emrin e parë Alexandrës Aleksandrës së tashme — Misini ishte i katërti djalë i farkëtarit Ramë. — Djallit tim kurrën e kurrës s'mund t'i them bija ime!

Në Mitrovicë, Prizren, Ferizaj e Prishtinë, nëpunësit e gjendjes civile shfaqnin habinë, posa t'u bënim pyetjet e para rreth atij që ishte bërë ajo. Ishte gjë e natyrshme, se për këso rastesh s'u kishte rënë të dinin e as të dëgjonin. Megjithatë në Prishtinë, një nëpunëse, pa u mëdysh na pat:

— Posi, këso rastesh ka mjaft. Por, me gabim të ofiça-



Misin Krasniqi para se ta ndërtonte gjininë

rit! Ndonëse në fillim na u duk se më kot ia kishim hyrë kësaj pune, që ngapak i ngjante ambicies së detektivëve të Perëndimit, fjalët e para të nëpunëses në Prishtinë na ngjallën shpresa, që pastaj do të ktheheshin në një humor, jo fort të rrahur nga penat e humoristëve tanë.

Na kishte mbetur edhe Peja, ku mbanim shpresa se do të ndeshnim identitetin e Alexandrës. Kjo do të ishte, madje, përpjekja e fundit. Por, pikërisht aty gjetëm të dhënat që na duheshin. Organi përkatës, ku bëhet ndërrimi i emrit, na ndihmoi shumë. Na i ofroi të gjitha shënimet.

Misin Krasniqi, me kërkesën e vet, do të qujhet Alexandra Krasniqi.

I katërti djalë, nga njëmbëdhjetë fëmijë

Asaj parambrëmjeje e kërkua në një lagje romësh por mezi i ramë në fije gjithë shtëpisë së Ramë Krasniqit, babës së njëmbëdhjetë fëmijëve, me profesion — farkatar.

— I kam pasur 11 fëmijë, tre më kanë vdekur, ndërsa tetë i kam gjallë: Hakiun, Eminin (të gjithë të martuar), pastaj Misinin, Sevdijen, Skenderin, Salihun dhe Mahirin (Më i madhi na luti që mos t'ia përmendim emrin). Të gjithë i kam rritur, si kam mundur e ditur. Njëmend jo me bollëk, por për të gjithë jam përpjekur t'i bëj të aftë për jetë: disa kanë kryer shkollën, disa kanë

marrë zanate, por ndonjë edhe e ka lëshuar rrugën që ua kam mësuar, kanë filluar të merren me punë të këqija. Hakiun, po për këto shkaqe, e kam përzënë nga shtëpia, kam hequr dorë prej tij botërisht. Jam i varfër, por dua të jetoj me nder.

Kështu thotë i ati i Misinit, Rama.

Por, ai ka nga një rrëfim për secilin, nga të tetit. Hivziu, Salihu, Feridja dhe Habibi janë nxënës — në fillore. Kurse Eminin, djali i tretë, është i punësuar — përkohësisht në Gjermani.

— Qebesa ky më ndihmon mjaft. Por, e kam dert punën e Sevdijes. Ajo e ka kryer shkollën e mesme të mjekësisë dhe ende s'punon, sikundër edhe Skenderi (18 vjeç), ndërkaq Mahirin e kam të vogël — 5 vjeç.

Misinin sikur e harron me qëllim. S'don t'ia zërë emrin ngojë. — Këtë e kam hequr nga tefteri. S'e njoh më për djalë timin. Po thonë se është bërë femër. E kam pasur më të mençurin, më të dashurin. Kur ishte i vogël, ishte shumë i dëgjueshëm, edhe më i bukur i ndër fëmijët e mij.

Atij sikur ia ka ëndja të flasë më gjatë për Misinin, ndonëse nuk i kursen të sharat, që ia drejton atij.

— Njëherë, kur po ndiqte mësimet në klasën e gjashtë apo të shtatë, vazhdon të flasë Rama, deshta t'ia ndërprej shkollimin. Në punë s'kishte kush të më ndihmonte. E dini, farkatarit i duhet, së paku, edhe një ndihmës. Dëshiroja të ishte ai që do të trashëgonte zëjën time, se ishte edhe më punëtori nga fëmijët. Mirëpo, ia pash sherrin mësuësit. Erdhi ai e më tha: «Ramo, djali është duke të mësuar mirë, është nga më të mirët në klasë. Mos e merr në qafë». Ma mbushi mendjen. Bile i tillë, nxënës i mirë ishte edhe në shkollë të mesme ekonomike, të cilën e kreu këtu, në Pejë.

E pash me «burrin»

Po Misini s'ishte i kënaqur me nivelin e dijës që kishte arritur gjatë shkollimit të mesëm. Donte të vazhdojë studimet.

— E me çka ta shkolloja. Farka tash nuk sjell para si dikur, thot Rama. Dhe prandaj, ai filloi të merrej me tregti, të imët, që kështu të tubonte mjete për ta vazhduar shkollimin. Kështu arriti në Slloveni.

Pas ndonjë kohe Ramës do t'i arrijë një letër me një përmbytje të pazakonshme.

«Të dashur prindër,

Tash e pas llogaritni se keni një djalë më pak, e një vajzë më shumë. Kam hyrë në punë. Jam bërë nëpunëse e administratës. Nuk e kaloj keq. Të gjithëve të fala.

Nga bija dhe motra e juaj, Alexandra»

Po kush t'i besonte përmbytjes së kësaj letre. Çdo gjë u dukej punë fëmijësh. Ndoshta do të jetë tallur. Hë, sa për t'i argëtuar prindërit, vëllezërit e motrat.

Një ditë ai (ajo — na falni) u duk në shtëpi. Do ta ketë ditur se i ati s'do ta priste mirë dhe prandaj nuk ishte futur në shtëpi andej kah hyn gjithë bota, por nëpër dritare. Ishte futur në shtratin e mëmës dhe ajo e kishte përqafuar, si fëmi-



Ramë Krasniqi, i ati i ish-Misinin, e tash Alexandrës: Si ti them djallit tim, bija ime! Jo kurrën e kurrës

jën e vet më. Por, atë e kishte zënë gjumi dhe kur i ati po i kërkonte diçka së shoqes, nëpër dritare, e kishte parë.

— Dreq o punë! Misini do të jetë. Po pse më veshmbathje femrash. Ajo njëmend qenka bërë femër!... Rama, habinë e vet e manifestoi me ashpërsi. Dhe Misini, që tashme quhej Alexandra, do të hidhej nga dritarja, me trup e kokë — femër.

— Ky rast më ndihmoi që atë ta njoh midis Zemunit. Pa pritmas e pash bashkë me një djalë të ri, njëmend të pashëm. Ecin si një burrë e grua. Ajo i bënte lajka atij, e ai ia kthente njësoj, — tregon Rama.

Nesër:

Unë e linda djalë, e tash...

UNË E LINDA DJALË, E TASH...

● Nënë, unë tash jam bija jote! — Është pjella jonë, s'kemi ku ta çojmë

Derisa po rrëfente për ish-djalin e vet, Misinin, tash Alexandrën, Rama mbyllte sytë, sikur donte të ikte sa më larg ngjarjes.

— Çfarë të bëja tjetër, kur e takova me burrin në Zemun, pos t'i mbyllja sytë, të ktheja kokën anash, të mos e shihja, — thotë Rama. Deshta ta harroja këtë që pash, por nuk u durova pa ia thënë të gjitha gruas.

Kur ishte këtu, ai, tash ajo, më pat thënë se bënte dashuri me një djalë, mjek, — ia kishte zbuluar e shoqja fshehtësinë që ia kishte besuar i biri (e bija). Por, s'dinte nëse do të martohehin.

Nëna, me të cilën po bisedonim më pastaj, është bashkëshortja e tretë e Ramës, meqë dy të parat i vdiqën.

— Çfarë t'u them për Misinin tim. E pata djalin e katërt. Si të tillë e linda. Pas tij më lindi vajzë. Edhe ai ishte si tre të parët, por... Bile e kam pasur më të zemrës, s'e di pse. Ishte çapëken. Çdo gjë i interesonte, ishte më i bukur, më i dashuri. Kur u rrit më rrëfehej për dashuritë që i lindnin për vajzat e bukura. U rrit, kreu edhe shkollën e mesme. Por, asgjë s'dalloja të veçantë nga djemtë e tjerë.

Në Slloveni e shmangu rrugën

Nëna, sikur don ta shfaqejsojë të birin (të bijën). Ia hedh rrethit, rrugëve të botës, që i kishte marrë në sy Misini.

— Atje, po, atje u prish. Përpara kurrë nuk më kishite thënë se i pëlqente të ishte vajzë. Prej andej na dërgoi këtë lajm. Na shkruante një herë se e kishte ndërruar gjininë. Por, nuk thoshte se e ka ndërruar edhe emrin. Po, fundja si mund ta ndërroj gjininë. Zoti e ka falur mashkull, tjetër s'mund të bëhet. Ajo puna e ylberit s'ma merr mendja t'i ketë bërë punë. Thonë se kështu mund të ndërrohet gjinia. Por, kujt i shkoi përdoshesh kjo? Askujt!

Ajo sikur nuk e ka të qartë. Vetë flet, vetë përgjigjet.

— Po si mund të bëhet djali vajzë. Këtë s'e kam dëgjuar ndonjëherë. Zoti mos

e dhashtë. Kurrë. Punë që s'bëhet! — thotë ajo.

Por, ju e patë mbasi që kishte ndërruar gjininë? — ia përkujtojmë asaj.

— Po, e pash. Njëmend i ngjante femrës. Tamam vajzë ishte bërë: me gjoksa, me vithe, me fytyrë... Doja ta shihja Misinin tim, por përpara kisha një tjetër, tash vajzë, përnjëmend, — vazhdon ajo.

Nuk u besoja syve

Tashmë e bindur se Misini s'ishte më Misin, por Alexandra, Nëna na flet për takimin e parë me tash — të bijën.

— Mbeta bukur vonë, me rangët e shtëpisë. Të tjerët flinin, si të vdekur. E kur njeriu është vetëm, kah s'i shkojnë mendët. E kujtoja Misinin, ashtu si djalë, më kujtoheshin bisedat me te, rrëfimet e tij për vajzat e

re. Mos më shtihoej gjë. Djalli, ndoshta! Por, sa më afër që i afrohesha dritares, shquaja më qartë sytë e fytyrën e një femre që ma kujtonte Misinin djalë. Ai do të jetë, nëse nuk jam

duke parë ndonjë ëndërr. Se thonë, çfarë kujton zhgëndërr të shfaqet ëndërr. Dhe ja, përpara syve të mij ishte Misini, një tjetër nga ai që e kisha lindur, që e njihja: edhe për nga pamja, edhe për nga zëri.

— Nënë, hapma derën. Unë jam, bija jote! — më tha.

— Po, ç'bijë, or. Të gjitha vajzat e mija i kam këtu, në shtrat.

Nëna pastaj do t'i jetë kujtuar Misini dhe letra e tij: «Tash-keni një djalë më pak dhe një vajzë më shumë...» Por, si do të ketë ngjarë, vallë!

— Përpara tash kisha tamam një vajzë, njëmend të bukur, të bëshme. E futa brendë, në dhomë. Tërë natën e lume asnjëra s'futem gjumë në sy. Kur po agonte, m'u duk se nata kishte rrëshqitur pa e diktuar. Më bëhej se asnjë fjalë nuk e kisha ndërruar me kë. Para syve më rrinte fytyra e tij, e saj, desha të them: një ten delikat, flokët bionde, gjokset e fryra, vithet e gjera...

«Nënë unë tash nuk jam më Misini. Jam Alexandra. Kështu kam dashur të quhem, se i pëlqente dashnorit tim. E kupton? Jam Alexandra: E dashuroj një mjek. S'dij nëse do të martohej a jo! Por tash duhem. Unë jam tamam femër...»

Këto fjalë s'i hiqeshin nga mendja nënë nënës, e cila nuk e ka parë më të birin nga ajo natë, kur e njohe si vajzë, ndonëse e kishte lindur për djalë dhe bile e kishte rritur si të tillë.

«Do të martohej me një mjek, ndoshta, nënë!»! Po si të martohej djali me djalë, nuk i mbushej mendja nënës se Misini tashmë ishte bërë vajzë, bile edhe emër tjetër kishte.

Nesër:

Më në fund — me adresë në xhëp



Misini, para se të bëhej ajo,

bukura që i pëlqenin, për të cilat më thoshte ndonjëherë se do të martohej me ndonjëherë. Vallë do të ishte mahi ajo që na kishte shkruar kohë më parë!

— Pasi i kreu punët e shtëpisë, mbeti edhe një kohë në shtrat duke munduar për këtë punë drejt dhe derisa po kotesha, ndjeva një trokitje të lehtë në kapakun e dritares së shtëpisë, — vazhdon të flasë Nëna.

E shtëpia e Ramës është një shtëpi përdhese, sikundër edhe të tjerat përreth, e llyer me llaç.

— Ndoshta më bëjnë vesht, thash. Kush të jetë, tash, në këtë kohë nate? Kurrë nuk do të më shkonte mendja se pas xhamit do të më shfaqej një hije fem-

MË NË FUND — ME ADRESË NË XHEP

Familja e Misinit nuk e kishte adresën e bijës së tyre — Alexandrës.

— As kemi adresë, as duam të dimë për te! — na thanë ata.

Në Shkollën e mesme ekonomike ndoshta do të ndeshim ndonjë gjurmë, që do të na çonte në shtëpi të tij, pardon — të saj. Ajo do të ketë kërkuar l'i jepej diploma me emrin e saj të ri. Ndryshe, s'do të mund të punonte punë me shkollë të kryer, me diplomën që do të kishte emër tjetër nga ai që e njihje rrethi. Shpresat dualën të sakta. Aty mësuam për organizatën punuese dhe qytetin ku punonte. Bile njëri na dha edhe numrin e telefonit të zyrës së saj. Kjo mjaftonte për ta takuar njeriun më të rrallë në vend. Ish Misin Krasniqi, e tash Alexandra Krasniqi.

Formojmë numrin në qytetin X, të Sllovenisë, për t'ia ndier zërin Alexandrës. Na thonë se është në pushim. Por, tani kërkojmë adresën e shtëpisë, ku banonte. Koleget e saj u treguan të kuptueshme dhe nuk ngurruan të na e tregonin. E si mos t'ia thonin «të vëllait» — siç isha identifikuar me telefon.

«Alexandra Krasniqi, Çufarieva I, qyteti X» — në Slloveni.

Kjo ishte adresa e saj.

«Do të vijë në një seminar atje. Më prit. Vëllau yt...» — ishte teksti i telegramit që shkrova unë.

Kisha caktuar edhe kohën e takimit. Por, kur s'e don, s'e

don. Lidhjet ajrore nuk më përshatashin. Mbetej treni. Por, edhe ky do të shënonte një vonesë prej 12 orësh. Ajo do të priste dhe do të ikte, e pastaj ec e gjeje. Me të panjohurin të takohesh në qytet të panjohur, është punë e vështirë.

Në shtëpi të saj

Megjithatë s'duhej hequr dorë nga qëllimi. Do të provoja edhe për të fundit herë. Qyteti X i Sllovenisë më ngjante i ftohtë, por që më tërhiqte, sigurisht derisa ta përmbushja kureshtjen.

Takova disa shqiptarë, por ata ma kthyen shpinën duke rrudhur krahët: «S'kemi dëgjuar për ndonjë emër të tillë në këtë qytet». Ndërkaq rruga Çufarieva, ishte një rrugë e re, për të cilën mezi dinin edhe milicët. Megjithatë e gjetëm shtëpinë ku banonte ajo.

Zonja e shtëpisë, në numrin një të rrugës Çufarieva, u tregua mikpritëse.

— Urdhëroni. Tash do të kthehet Alexandra. Ka shkuar në vikend. Do të vijë më vonë. Më ka porositur që nëse vjen (ajo kujtonte se do të jem vëllai i saj, sikundër që e kisha adresuar telegramin) të të pres mirë. Ja, urdhëroni në dhomën e saj. Do të ketë ndonjë gjë për të lexuar.

Po si të hyja në dhomën e

staj. Dhe çfarë lypa, e gjeta. Pas pak iu falënderova të zotës së shtëpisë së Alexandrës. I thashë të më kërkonte në hotelin që ndodhej afër stacionit të autobusave. Të pyeste aty «A ka ndonjë prosi për Alexandrën...» Në hotel lash porosinë: «Nëse më kërkon një femër, i trego se gjendem në dhomën numër...» Nga dritarja e dhomës ku kisha zënë vend, vështroja secilin autobus që arrinte, mos do ta shihja vajzën që e kisha njohur në fotografi. Por, pritja që e kotë. Ajo ishte vonuar në vikend.

Takimi me Alexandrën

Në mëngjes më zgjoi portieri.

— Të pret një vajzë, poshtë, në hol! — më porositte zëri nga telefoni.

Ishte Alexandra, vajza që e kisha parë në fotografi: bjondinë, shtathedhur, e bukur...

Takimi i parë sikur e befasoni. Ajo mbeti e stepur, pa fjallë.

— Nuk jam vëllau yt, sikundër që e sheh. Jam një gazetar. Tash e sa ditë të kërkoj. Të bisedojmë, po deshe, — ia them shqip, ndërsa ajo po kundërshtonte bisedën me një sllovenishte të shkoqur.

Zëmë vend në një kënd të hotelit dhe i tregoj se më parë kisha biseduar me mjekët, ata që ia kishin sendërtuar ëndërrën që ta ndërronte gjininë. Kjo sikur e përmendi. Tah ajo dukej e interesuar për të biseduar.

— Po ç'thonë mjekët? — më pyet. Do të ketë sukses puna? vazhdon ajo të rreshtojë një vistër pyetjesh, duke hequr nga fytyra blejt e flokëve bjonde që i derdheshin nëpër atë fytyrë të njomë, prej femre, për të cilën askush s'do të thoshte se do të ketë qenë ndonjëherë mashkull. Edhe zërin, edhe lëvizjet, edhe të qeshurat, edhe mimikën e fytyrës, çdo gjë duket femërore te ajo, që njëherë ishte ai. E mbi të gjitha shquhej eleganca e lëvizjeve.

Për ditët në Kosovë, nuk dëshiroj të flas. Ato kanë përrënduar, nuk ekzistojnë më. Tash jam kjo që jam — Alexandra Krasniqi, vajza që don të martohet, që kurrë s'ka qenë mashkull...

Nesër: Më pëlqente të isha vajzë



Misin Krasniqi: vërtet kam qenë mashkull, por tash jam Alexandra Krasniqi, kjo që jam tash

saj? Kur do të vinte ajo mund të frikësohej kur të shihte një fytyrë të panjohur, që s'i ngjante vëllait fare. Aty për aty më lindi ideja të hulumtoja ndonjë fotografi të saj, më të re, sa për ta identifikuar pa-

MË PËLQENTE TË ISHA VAJZË

Megjithatë, Alexandra do të na flasë edhe për rininë e saj në Kosovë, për ditët shkollore, për dashuriçkat.

— Sa herë luanim, si femijë, më pëlqente të luaja rolin e femrës. Luanim, ta zëmë burrë e grua dhe unë gjithnjë dëshiroja të bëhesha grua, nusja. Më pëlqente se lëvizjet e femrës më dukeshin më elegante. Por, veten e ndjeja maskkull. Bile, pasi mbusha të pesëmbëdhjetat, më pëlqenin ca vjaza. I shihja ëndërr. Mendoja edhe për martesë. Megjithatë, një shok klase më pëlqente. Dëshiroja të isha femër dhe atë ta kisha dashnor, pastaj edhe burrë. Por, vetë isha maskkull. Ishte punë që nuk bëhej. Edhe këtu në Slloveni disa herë më është kujtuar. Dashuria ndaj tij sikur erdhi duke u trashur. Ai sigurisht nuk e din këtë gjë. Dhe, njëmend është i bukur. Pastaj fillova të dashurohem edhe në meshkuj të tjerë. Femrat më tërhiqnin gjithnjë e më pak. Çdo maskkull që më ngjante në shokun e klasës, dëshiroja ta kisha burrë, së paku dashnor.

E ndjeja veten si femër

— Pasi erdha në Slloveni, lidha dashuri me një vajzë. Në fillim takoheshim shpesh, pastaj më dukej se bëja një punë të pamoralshme. Nuk më pëlqente më. Shiheshim gjithnjë e më rrallë. Nga takimet më të nuk ndjeja asgjë. Dëshiroja të kishim role të kundërta: ajo të jetë maskkull, unë femër. Por, kjo nuk ishte punë që bëhej. Bile, fillova ta urrej. E dëshiroja maskkullin më shumë. U muar vesh, jo si homoseksual. Dëshiroja që ai t'i ngjante shokut të klasës nga Kosova.

Kështu rrëfen Alexandra, e cila pastaj më tregon se tash dëshironte edhe të sillje si femër, t'i marrë maniret e saj. Por, ato sikur i vinin spontanisht, vetë, padiktueshëm.

— Bile, thotë ajo, fillova ta



Faksimil i reportazhit nga «Arena»

ndjeja veten keq. Në një anë isha maskkull, e në tjetrën — më pëlqenin maskkujt. Kishte edhe të tillë, meshkuj, që më ofronin dashuri. Por ata ishin homoseksualë. Ashtu s'doja. Do të ketë ilaç, vallë, kjo punë? — e pyeta veten, por rrugëdalje s'gjeja. Kështu kaloi net pa gjumë.

Një natë derisa ai po luftonte me preokupimet e veta, të pazakonshme, për ta mashtruar gjumin, nis të lexojë «Arë-nën».

«Babai u bë nënë» — kështu titullohej një reportazh, për babën e tre fëmijëve, që pastaj e kishte ndërruar gjininë, ishte bërë femër.

— Thashë, me vete, edhe kjo u bëka. Por, nga t'ia filloja? Aty mësova se ishte i nevojshëm konsultimi me psikiatrin.

Dëshira bëhet njëmendësi

— Konsultimi me psikia-

trin më ngjalli jo vetëm shpresat, më thotë Aleksandra. Pasi bëri kontrollin tim në hollësi, më tha se ti ke gjasa të mira ta ndërrosh gjininë. Këtë punë mund ta bësh edhe në vendin tonë dhe pikërisht në Lublanë. Një ekip ekspertësh të dalluar të mjekësisë tash do t'ia fillojnë të merren edhe me këtë punë. — më thotë ai. Ti do të ishte një nga pacientët e parë.

Alexandra thot tash se nuk është e sigurt a ishte gëzuar apo pikëlluar. Çfarë do të thoshte bota, të njoftshmit e të panjoftshmit?! Në anën tjetër s'ishte e sigurt ndaj mundësive që ofronte medicina. Mos ishte edhe kjo si legjenda për ylberin... Më dhembësej Misini i dikurshëm, por e dëshiroja Alexandrën, që do të bëhesha. Fitoi, në fund dëshira. Misini doli para grupit të mjekëve. Provat, të cilave iu nënshtrua, dolën të suksesshme. Tash duhej të fillohej terapia me hormone...

Misini gjithnjë e më pak i ngjante më Misinit djalë. Anonte kah Alexandra. Edhe garderoba ndryshoi. Nuk veshte as rrobe meshkujsh. Nga dita në ditë filloi të ndryshonte edhe pamja. Nga jashtë askush s'do ta merrte për tjetër, pos femër. Ndërroi edhe shoqërinë. Tash sillje me kolege, tamam shoqe. Ishte nga më të bukurat ndër to, edhe ku punon, edhe ku banon.

Por ndërrimet fiziologjike, që pësonte Misini, zurën t'ua vrisnin syrin atyre me të cilët punonte. Këto s'mbetën pa u vërejtur as nga rrethi ku ajo banonte. Flitej me zë për të gjitha këto. Sekretit medicinal po zbulohet. Asaj i duhej ta ndërronte rrethin... Tash, për çdo muaj. Larg e më larg. Deri tash ajo ka ndërruar tetë — nëntë banesa, dy-tri qytete, shumë vende pune.

Pse, kështu, Alexandra? — e pyetëm.

— Jo nga shkak se do ta marrin vesh se kam ndërruar gjininë. As pse do të flisin. Por më pengon kur më hedhin fjalë, ndonjëherë fyese. Shkurt: moskuptimi nga rrethi më pengon. Se kjo s'është punë që mbahet e feshhtë.

Nesër: Fotografia e grisur

FOTOGRAFIA E GRISUR

- Pse Misini e Zgjodhi emrin Alexandra
- Letra e parë prindërve

Ekipi i përbërë prej njëmbëdhjetë mjekëve - specialistë të Qendrës Klinike Medicinale, pasi ia bëri analizat e nevojshme, e pranoi Misinin si pacient, nga të parët, i cili do ta ndërronte gjininë: nga mashkull të bëhej femër.

- Askujt s'pata besim t'i rrëfeshesha. Kjo veçanërisht më ngarkonte. Më dukej se mbaja në shpinë një barrë, të

andra Krasniq. Pse e zgjodh pikërisht këtë emër, do të më sojmë më vonë. Vetë ajo do të na thotë.

- Pastaj edhe zyrtarisht e bëra ndërrimin e gjinisë. Në rubrikën ku më parë më shkruante mashkull, tash figuronte - femër. Duhej ta ndërroja edhe emrin. Çfarë emri? - e lash për më vonë.

Po si t'ua kumtonte prin-



Një kujtim (i grisur) i fëmijërisë

andra» - kështu e kishte shkruar letrën, të parën pasi e kishte ndërruar gjininë, drejtuar prindërve. Letrën do ta shoqëronte edhe me një fotografi, nga e cila do të shihej e bija e tyre, ish-Misini, të cilin e kishin llogaritur djalë. Disa herë, pastaj, e kishte lexuar e rilexuar dhe më në fund e kishte adresuar për në Pejë.

Për këtë letër na treguan edhe në Pejë. Na thanë se ajo kishte dërguar edhe letra të tjera. Bile kishte kërkuar edhe përgjegje. Porse, letrat e saj ishin grisur pa u lexuar. Bile jo vetëm ato. Ishin grisur edhe libra e fotografi të tjera. Por, nëna si nëna, e kishte nxjerrë nga copat e fotografive të shqyera një më të ruajtur. E kishte ruajtur dhe kur biseduam me të na e tregoi.

- Mos ta shohin të tjerët!
- më pat thënë ajo. Do të ma zënë për të madhe.

Pengesat ligjore

Tashmë kur nuk i ngjante më Misinit, Alexandra duhej t'i ndërronte edhe dokumentet.

- Kjo është punë që s'bëhet, shok! - i tha nëpunësi i gjendjes civile. Emri mund të ndërrohet. Këtë e lejon ligji. Por, gjininë jo. Kjo çështje nuk parshihet me kurrfarë ligji ndër ne.

Po tash Misini njëmend nuk ishte meshkull. Ishte femër jo vetëm për nga dukja. Që ta zgjidhte problemin i ndihmoi prapë Qendra Klinike Medicinale e Lublanës. I dha dokumentin përkatës, që u muar parasys nga organi përkatës.

Po emri? Nga erdhi kjo - Alexandra? - e pyesim.

- Njëmend më vinte vesh-tirë ta ndërroja emrin që e kisha mbajtur 22 vjet. Por, unë kisha braktisur gjininë, e lëre më emrin. Tash duhej gjetur një emër që do të më largonte sa më shumë nga Misini. Pastaj as në Kosovë nuk e kisha mendjen të jetoja, bile as të kthehem. Një ditë, derisa po shëtitnim me dashnorin tim, më tha se do t'i pëlqente emri Alexandra. Propozimi i tij më pëlqeu, se edhe mua më pëlqenin emrat që kishin ndonjë «X». Më pastaj nuk e vrava mendjen me këtë punë. E vendosa: kështu do të quhem dhe ashtu u bë.

Po mbiemrin?

- Edhe ndonjë ditë do ta ruaj Krasniq (pa atë i-në). Pastaj do të kem mbiemër të ri, më të shkurtër. Së paku ky, i dashuri im kështu e ka, - thotë ajo.

Nesër: Më njihnin herë femër, herë mashkull

SOCIALISTIČNA FEDERATIVNA REPUBLIKA JUGOSLAVIJA



SA 319154

OSEBNA IZKAZNICA

ALEXANDRA

KRASNIĆ

Letërnjoftimi i ri i Misin Krasniqit

cilën mezi pritsha ta shkarkoja. Një ditë të gjitha ia thashë një shoqeje, me të cilën punoja.

Tashmë ai merrte terapinë, që do ta shndërronte në - ajo, siç kishte dashur vetë.

- Ilaçi i parë që fillova ta përdori ishin hapat «Antiandrogen» (Androcur), që vepron kundër hormoneve të mashkullit, dhe «Estrogen» («Stilbestrol»), që forcojnë hormonet e femrës. Këso barnash merrsha çdo muaj, - tregon Alexandra.

Mirëpo ato nuk i kushtonin pak atij (gjithnjë po gabojmë) - asaj. Çdo muaj nga 8000 dinarë (të rinj) për këto barna, nga të cilat sigurimi social i mbulon 60 për qind, e të tjerat vetë pacientit.

- Efekti i barnave dukej sheshazi. Jo vetëm ndjenjat, por ndryshohej edhe pamja ime. Për ditë e më shumë i ngjaja asaj që kisha dëshiruar.

Edhe ndonjë ditë, e pastaj nuk do të ekzistonte më Misin Krasniqi. Ai do të quhej Alex-

dërve këtë punë. T'u shkruante, të shkante vetë, ta shihnin se njëmend i biri i tyre tash ishte e bija e tyre!... Si është më mirë, si u bie më lehtë atyre?!

- Do t'u shkruaj dhe bashkë me letrën do t'ua dërgoj edhe një fotografi. Të më shohin, ta marrin vesh edhe ata. Më mirë prej meje se nga të tjerë. Isha shumë e vendosur, thotë ajo tash.

Tarh jam - ajo

- Me mend kaheër e kisha skicuar letrën që do t'ua dërgoja prindërve. Veprimi im atyre do t'u dukej gjë e rëndë. Ndoshta do të skuqen para të tjerëve, por më dukej se pa arsye. Megjithatë do t'u shkruaja:

«Tash keni një djalë më pak, e një vajzë më shumë. Misini kurrë s'do të jetë më Misin, por Alexandra. Kështu më pëlqente dhe ashtu veprava. Mos ma zirni për të madhe. Të gjithëve ju dua, Alex-

MË NJIHNIN HERË FEMËR, HERË MASHKULL

● Edhe isha mashkull, e vallëzoja si femër ● — Dashurçkat dhe përpak — më mbetën në qafë dy punëtorë ● — Ç'shkruate në kartelin e ambulancës

Misinin, që i kishte mbushur vjetët për rekrutim, një ditë i erdhi ftesa të dalë para komisionit ushtarak. Por ky s'ishte më për ushtri. Tashmë ishte ajo dhe — ato nuk bëjnë shërbim ushtarak ndër ne. Nderkaq në listat e rekrutëve ajo figuronte si mashkull. Fundja kush do t'i besonte asaj, edhe sikur t'i sqaronte çështjet me shkrim ose me gojë. Komisioni do ta kërkonte Misinin mashkull, e jo këtë — femër. Por, Qendra Klinike e Lublanës i lëshoi Alexandres një dëshmi se ai ishte bërë ajo, se nuk ishte për ushtri.

Kështu u kryen të gjitha formalitetet që e pengonin Misinin që tash ishte bërë femër. Megjithatë, fillimi i jetës në fustan nuk ishte i lehtë.

— Ata me të cilët punoja, herë më njihnin si mashkull, herë si femër. Në punë shkoja me pantolla, me gjoksa të shtrenguar e të maskuar. Vëshesha me gjera të trasha, që i amortizojnë vijat e femrave. Mirëpo, në shtëpi dhe nëpër lokale e ballo, e heqja maskën. Kjo ma vështirësonte jetën. Posaçërisht në fillim.

— Kur luaja ndonjë lojë të lehtë me meshkuj, nëpër ballo, e kisha më së vështiri. Trupat qepeshin me njëri tjetrin, sikur shkriheshin në një, e unë ende isha mashkull. Më ka-



Alexandra Krasniqi, pas intervenimit të mjekëve, tash kur s'është më mashkull, por femër

përmendim emrin e qytetit) dy kosovarë, shqiptarë, zunë t'i hedhnin fjalë.

— Unë do të shkoja në një stacion më larg, me punë. Ata, duke kujtuar se isha sillovene, filluan të më flisnin në serbo-kroatishite: »Sa e bukur qen-ke«, »Nga të kemi?«, »Ku udhëton?«, »Pse udhëton vetëm moj bukuroshe?«, »Të duhet shoqëria dhe kush e din çfarë më. Por, unë nuk ua vara veshin. Mendova tash do të më heqen qafe. Por, kur e hetuan indiferencën time, filluan të bisedojnë shqip dhe prapë për mua.

»Eu, një kali pare e paska, bre Zekë!...« — i thotë njëri tjetrit. Pastaj ata e ndjekin me sy dhe kur u nis treni, edhe ata hynë në kupenë e saj.

— Bisedoja me ta në sillovenisht. Më thanë se punonin në një fabrikë të atij qyteti dhe se ishin nga Kosova. Por, kur insistova ta dija nga cili lokalitet, duke ua përmendur vendet, sikur i habita. »Ku i dika, thinesha, të gjitha!« — shfaqti njëri habinë. Në ndërkohë Zeka doli përjashta dhe pasi u kthye i tha tjetrit: »Dan, këtë sillovenen ose me hatër, ose me zor. Njëra s'huq«. Më besoni, u frikësova. Dola para se të arrija në stacionin që e kish mendjen, për ta pritur trenin tjetër që shkonte andej pas tri orësh.

Anemneza sociale dhe diagnoza

Alexandra, pastaj, e çliruar që m'i kishte thënë gati të gjitha, nxori kartelin e ambulancës.

— Ja, urdhëro se ç'shkruan. Këtu të gjitha janë.

Dhe lexoj:
»Spitali i Përgjithshëm — ambulanca psikiatrike, data 1.03.1978.

Misin Krasniqi u lind më 4.07.1956 në Pejë. Rrjedh prej një familje punëtoresh. Babai i saj është pensionist. Ka tetë fëmijë. Misini është djali i katërt, nga shtatë vëllezër. Tre vëllezërit e lindur para tij dhe një motër pas këtij janë të martuar. Ka kryer shkollën e mesme ekonomike në Pejë. Pas kryerjes së shkollës, një herë punoi fizikisht e tash është nëpunës. Me shtëpi rrallë korrespondon, e edhe më rrallë shkon atje...« Psikiatri dr. Andrej Veble pastaj jep diagnozën.

»Është gjinindërrues. Një herë e ka dashur një djalë, e pastaj ka filluar të ndiej veten si femër. Nuk është homoseksual. Shpesh dashurohet në meshkuj. Banon te një grua, me qira. Në punë vishet si mashkull, kurse jashtë si femër. Rrethi e njeh herë si femër, herë si mashkull. Nëse

nuk e ndërron gjininë, mund të ketë pasojë psikike deri në vetëvrasje. Tash mban korrespondencë me një student, i cili kujton se është femër. Deri më tani i është rrefyer vetëm një shoqeje të punës...«


Pastaj vazhdon:

»Pacienti i ka të gjitha shenjat e femrës. Nuk dallohet as për nga veshmbathja. Edhe zërin e ka të femrës. Ka një inteligjencë të rrallë, mbimesatare...«

Kjo, zatën edhe ishte viza që atij ia hapën dyert e Qendrës Klinike Medicinale, në Lublanë, ku iu shtrua terapisë hormoniale dhe kirurgjike, pas të cilave ai e ndërroi gjininë, u bë përgjithmon ajo, shoqja Alexandra.

Për këtë kliente, prof. dr. Jozhe Llokar na tha se intervenimi mjekësor pati më së shumti sukses nga të pesët, sa provuan ta ndërronin gjininë në këtë Qendër. Sigurisht rasti i saj i ndërrimit të gjinisë do të hyjë në analet e medicinës si më i suksesshmi deri më tash jo vetëm në vendin tonë.

NESËR: ALEXANDRA MENDON TË MARTOHET DHE Ç'THO-NË EKSPERTËT



Vërtetimi se ai s'është më ajo dhe prandaj të fshihej nga evidenca e rekrutëve

plonte djersë nga mundi. Maskohesha si dija. Problemet vazhdonin edhe pas ballos. Mbrohesha nga meshkujt me arsye të ndryshme.

Një mbrëmje, shpërtheu një grindje mes dashnorit të saj dhe disa djemëve.

— Ata më hodhën fjalë dhe ky që bëja dashuri me të e manifestoi xhelozin aq shumë, sa u këceu atyre në qafë. Për fat ndërhy në tjetër dhe grindja përfundoi pa pasojë.

Ndodhia në stacion

Një ditë, derisa Alexandra po priste trenin në stacionin e qytetit ku punon (me qëllim dhe me kërkesën e saj nuk e

ALEXANDRA MENDON TË MARTOHET

● Dashnori i saj, dr. Manfred Zilerh: »Me Alexandrën u njohëm në spital dhe me te do të martohem« — Ç'thonë ekspertët për gjinidërruesit

Misin Krasniqi, tash Alexandra, e ka ndërmend të martohet. Bile thot se e ka zgjedhur edhe të dashurin. Po si e mendon martesën një ish-mashkull me një mashkull?

— Unë deri dje isha mashkull dhe tash s'e kam vështirë t'i kuptoj ata. Kam disa kandidatë, por njërit ia kam vënë syrin. Është një mjek, kirurg. Por kjo s'varet vetëm nga unë. Dasma sigurisht do të jetë e thjeshtë, pa daulle, pa kangaqec, ndonëse kur isha djale mendoja dhe dëshiroja të martohesha me »zhurmë«.

Po a do të ketë fëmijë ajo?

— Ende s'e di. Fundja do ta rris ndonjë që do ta adoptoj. Nëse lindi dhe po më lindi djalë, ai do të quhet Misin, — thot ajo.

Dëshironim të bisedonim edhe me të »zgjedhurin« e saj.

Dr. Manfred Zilerh na tha se Alexandrën e njohi në spital, derisa po priste ta ndërrojnë gjininë.

— Që atëherë, gjithmonë jemi bashkë. Edhe emrin që e mori pas ndërrimit të gjinisë ia propozova unë. Ajo është si të gjitha femrat e tjera, — rrëfen dr. Manfredi.


Ai nuk kursen as fjalë të tjera, të zgjedhura për Alexandrën si femër, ndoshta — bashkëshortin e ardhshme.

E kur do të ndodhë kjo, si pohojnë ata vetë, varet nga suksesi dhe koha e mjekimit.

Suksesi i mjekësisë, por problem etik

Ç'po ndodh në Klinikën tuaj? — e pyetëm psikiatrin, prof. dr. Jozhe Llokarin, emri i të cilit i ka kapërcyer kufijt e Jugosllavisë.

— Pesë persona: tre meshkuj e dy femra, janë pacientë të Qendrës Klinike Medicinale të Lublanës, që kanë shfaqur dëshirën të ndërrojnë gjininë. Ata tashmë u janë situar terapisë dhe intervenimeve kirurgjike dhe me gjasë të mira që të bëhen çfarë kanë dëshiruar. Problemi, megjithatë, është i komplikuar dhe s'jemi pa dilema. Ndërmarrja jonë vërtet shënon një hap përpara në arritjet e mjekësisë si shkencë, porse mbetet institucionalizimi etik i ndërmarrjeve të tilla, bile edhe nga aspekti juridik. Në anën tjetër shtrohet pyetja: çfarë të bëhet me ata që dëshirojnë ta ndërrojnë gjininë, që marrin hormone përkatëse dhe bëhen një lloj hemafroditesh: as mashkull, as femër. Dhe në këso rrethanash ata me siguri do të kërkonin intervenime mjekësore gjatë, jashtë kufijve të vendit. Ky motiv



Pamja e pjesshme e Lublanës: Qendra Klinike Medicinale e këtij qyteti po e mban hapin me të arriturat e shkencës evropiane.

dhe aspekti human i çështjes tervenimi kirurgjik për këso na ka shtyrë të mendojmë për zgjidhje të këtyre rastëve edhe ndër ne, — thot dr. Llokar. Ka duan të bëhen meshkuj. Ndërpasur raste që ata të cilët kanë bërë përpjekje ta ndërrojnë list kirurgjisë plastike shton gjininë pa përkujdesje profesionale, të përfundojnë tragjikisht. Prandaj s'është fjala vetëm për një »eksperiment« të thjeshtë, por për një imperativ që e shtron koha. Kjo ishte arsyeja e formimit të ekipit të specialistëve në Klinikën tonë, — përfundon ai.

Bisedojmë edhe me psikologun prof. dr. Hubert Pozharinikun. Çdo mashkull s'mund të bëhet femër, sikundër që edhe çdo femër s'mund të bëhet mashkull. Çështja e ndërrimit të gjinisë është shumë më e komplikuar dhe një gabim në diagnozë mund të jetë fatal për pacientin, — thot ai.

Pacienti mund të pendohet vetëm para intervenimit kirurgjik

Nëse mjekët vendosin, në bazë të analizave të mëparshme, t'ia ndërrojnë gjininë një pacienti, si pari fillohet me hormone. Pas një kohe, nëse pacienti i përshtatet gjinisë së re, bëhen edhe analiza të tjera dhe ekipi i mjekëve jep mendimin definitiv. Çdo gjë që bëhet në sajë të hormoneve, mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, por pas intervenimeve kirurgjike — s'ka kthim pas. Ndërkaq përvojat shkencore tregojnë se edhe pas të gjitha këtyre — pacientët mund të kenë telashe.

Prof. dr. Srečko Rajner — gjinekolog, na rrëfeu për një infermiere të kësaj Qendre Klinike, e cila kishte shfaqur dëshirën të bëhej mashkull, por meqë kërkesa nuk i ishte marrë parasysh, ajo kishte shkuar jashtë shtetit dhe kishte bërë ç'kishte pasur ndërmend. Tash ajo jeton e punon si mashkull. E si na tha ai. in-

tervenimi kirurgjik për këso rastesh është shumë i ndërlikuar, por ngapak kuar, sidomos te femrat që duan të bëhen meshkuj. Ndërkës, dr. Marko Godina, specialist kirurgjisë plastike shton se kjo punë që bëhet për ndërrimin e gjinisë jo vetëm që është e ndërlikuar, por ngapak edhe e pasukses. Njëmend meshkujve mund t'u jepet pamja e femrave dhe femrave ajo e meshkujve, porse asnjë s'mund të shndërrohet plotësisht në gjini tjetër. Megjithatë ai konsideron se kjo është një punë humane, të tillët i çliron nga vuajtjet.

— Në Kongresin Evropian të Kirurgëve Plastikë, të mbajtur më 1976, ndër të tjera u tha se në këtë kontinent ka rreth 2.600 vetë që kanë ndërruar gjininë, prej të cilëve rreth 350 me operacione, — na tha ai.

Por, ekziston edhe një pengesë. Ndërrimi i gjinisë në vendin tonë nuk është e i rregulluar me kurrfarë ligji pozitiv, por as i ndaluar, pos në rastet kur një gjë e tillë do të bëhej pa pëlqimin e pacientit. Prandaj pacientët e tillë kanë telashe edhe me formalitetet juridike. Prof. dr. Lubo Bovcar, jurist nga Lublana, konsideroi se edhe kjo çështje duhet të rregullohet me ligje. Jemi në shekullin e atomit dhe të fluturimeve edhe në planetet e tjera, prandaj edhe këso »kuriozitetesh« duhet pritur.

Sekretari i Punëve të Brendshme të Mariborit, Armin Privšek i cili u muar me tri këso rastesh në Slloveni, na tha se me gjithë pengesat juridike, në sajë të dëshmiave të sjella nga Qendra Klinike Medicinale e Lublanës, atyre i dha në letërmoftimet e reja me gjini të re, përkatësisht Fundja, për ndryshime fizike që pësojnë, qytetarët i detyro ligji të paraqiten në organet përkatëse.

Fund